



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 285/prot
2

Gramsh më 30/01/2020

V E N D I M

Nr. 01, date 29 / 01/2020

“PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIA NR. 97 DATË 30.12.2019 “ PËR
MIRATIMIN E NUMRIT MAKSIMAL DHE NIVELIT TË PAGAVE E TË SHPËRBLIMEVE TË
PUNONJËSVE E PERSONAVE TË TJERË, TË ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR,
TË BASHKISË GRAMSH, PËR VITIN 2020 “**

Këshilli i Bashkisë, në mbledhjen e tij të datës /01/2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe P/Vendimin “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit bashkiak nr.97 datë 30.12.2019 “Për miratimin e numrit maksimal dhe nivelit të pagave të punonjësve e personave të tjerë, të zgjedhur e të emëruar, të Bashkisë Gramsh, për vitin 2020” të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54 pika “ç”; Ligji Nr.152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil” (i azhornuar); Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); Kodi i Procedurave Administrative të RSH; VKM Nr.177, datë 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.165, datë 02.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore”, I ndryshuar, VKM nr.175 datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe drejtuesve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar”;

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në tabelën I “Struktura Organizative dhe niveli i pagave për administratën e bashkisë(viti 2020), pika 10 “Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Burimeve Natyrore”, në Sektorin e Ujitjes e Kullimit , pika 10.26 si më poshtë :

10.26	Manovrator/shofer	Leje drejtimi	1	Kod Pune	Vkm nr.202 L.2 IX	36000	(1%XSHP)+SHP
-------	-------------------	---------------	---	----------	-------------------	-------	--------------

2. Të miratojë ndryshimet në tabelën II “Struktura Organizative dhe niveli i pagave për njësitë vartëse të bashkisë(viti 2020), pika 4 “Drejtoria e Arsimit ,Kulturës dhe Sportit”, në Qendrën Kulturore të Fëmijëve, pikat 4.2 dhe 4.4, si më poshtë :

4.2	Drejtori qendres	Larte	1	Kod Pune	Vkm 191 L.3/P.2	51000	PG+(PGX2%)+SHP
4.3	Përgjegjës	Larte	2	Kod Pune	Vkm 191 L.3/P.4	44000	PG+(PGX2%)+SHP

4.4	Instruktor	Larte	4	Kod Pune	Vkm 191 L.3/P.6	42500	PG+(PGX2%)+SHP
-----	------------	-------	---	----------	--------------------	-------	----------------

3. Të miratojë ndryshimet në tabelën II “Struktura Organizative dhe niveli i pagave për njësitë vartëse të bashkisë(viti 2020),pika 4 ”Drejtoria e Arsimit ,Kulturës dhe Sportit”, në Arsimin Parashkollor ,pikat 4.29 dhe 4.30 si më poshtë :

4.29	Drejtor kopshti me ushqim e Drejtor kopshti pa ushqim	Larte	6	Kod Pune	Vkm 191 L.3/P.3 L.3/P.5	45000 42500	PG+(PGX2%)+SHP
4.30	Edukatore	Larte/ Mesëm pedag	67	Kod Pune	Vkm 191 L.3.P.8 L.3.P.10	36650 34000	PG+(PGX2%)+SHP

4. Të miratojë ndryshimet në tabelën III “Struktura Organizative dhe niveli i pagave për njësitë Administrative (viti 2020), Njësia Administrative Lenie,pika 26 si më poshtë :

26	Agjent tatim-taksa	1	M	Kod.Pune	vkm177- P.19	38000	PG=(1%x30000)+38000
----	--------------------	---	---	----------	-----------------	-------	---------------------

5. Të miratojë ndryshimet në tabelën III “Struktura Organizative dhe niveli I pagave për njësitë Administrative (viti 2020), Njësia Administrative Kukur,pika 35 si më poshtë :

35	Inspektor sherb publike dhe arkiv	1	M	Kod Pune	vkm177- P.19	38000	PG=(1%x30000)+38000
----	-----------------------------------	---	---	----------	-----------------	-------	---------------------

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe Kryetari i Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sekretari i Keshillit

Endri MEMA

Konceptoi : E.Mema
Pranoi .G.Lena
Miratoi: G.Lena

Kryetari i Këshillit

Greta LENA

